

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS  
REKTORATI

Drejtoria e Kurrikulave

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë më \_\_\_\_\_ 2018

**LËNDA: Kriteret e pranimit në UPT, për vitin akademik 2019-2020**

**DREJTUAR: Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë  
Drejtoria e programeve të Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë  
Tiranë**

Në përgjigje të shkresës suaj Nr. Nr.2641, datë 08.03.2018, "Për kriteret e pranimit në programet e studimit të IAL për vitin akademik 2019-2020", po ju përcjellim kriteret e pranimit në programet e studimit të ciklit të parë në UPT, për vitin akademik 2019-2020:

**A.** Kriteret e pranimit për programet e studimit të Ciklit të Parë, të ofruara nga Fakultetet e UPT si më poshtë:

**1. Fakulteti I Inxhinierisë Mekanike** me programet e studimit:

- Bachelor në Inxhinieri Mekanike
- Bachelor në Inxhinieri Materiale
- Bachelor në Inxhinieri Tekstili dhe Modë
- Bachelor në Inxhinieri Ekonomike

**2. Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike** me programet e studimit:


- Bachelor në Inxhinieri Elektrike-Profil i Automatizim i Industrisë
- Bachelor në Inxhinieri Elektrike-Profil i Energjitikë
- Bachelor në Inxhinieri Mekatronike

**3. Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave** me programet e studimit:

- Bachelor në Inxhinieri Gjeoinformatikë
- Bachelor në Inxhinieri Gjeoburime
- Bachelor në Inxhinieri Gjeomjedisë
- Bachelor në Shkenca Toke

**4. Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit** me programet e studimit:

- Bachelor në Inxhinieri Elektronike
- Bachelor në Inxhinieri Telekomunikacioni



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS  
REKTORATI

Drejtoria e Kurrikulave

- Bachelor në Inxhinieri Informatike

**5. Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit** me programet e studimit:

- Bachelor në Inxhinieri Ndërtimi
- Bachelor në Inxhinieri Hidroteknikë
- Bachelor në Inxhinieri Mjedisi
- Bachelor në Inxhinieri Gjeodet

**6. Fakulteti i Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike**, me programet e studimit:

- Bachelor në Inxhinieri Matematike
- Bachelor në Inxhinieri Fizike

janë si më poshtë vijon:

- Kandidatët duhet të kenë mesataren e shkollës së mesme mbi 6 (gjashtë).
- Renditja e aplikantëve do të bëhet referuar pikëve të grumbulluara sipas formulës:

$$[0.7 * \text{Mes}_{(\text{VKM})} + 0.3(0.5 * \text{Mes}_{(\text{Matematike})} + 0.4 * \text{Mes}_{(\text{Fizike})} + 0.1 * \text{Mes}_{(\text{Kimi})}) * K_{\text{koef. Shkollës}} * 1000$$

Ku:


- **Mes<sub>(VKM)</sub>**, nota mesatare e thjeshtë, e të gjitha viteve të shkollës së mesme, e përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave për vitin akademik 2019-2020, sipas Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë, në Republikën e Shqipërisë" neni 74, pika 1;
- **Mes<sub>(Matematike)</sub>**, nota mesatare e thjeshtë e matematikës në të gjitha vitet e shkollës së mesme, përfshirë rezultatin në provimet e Maturës Shtetërore;
- **Mes<sub>(Fizike)</sub>**, nota mesatare e thjeshtë e fizikës, në të gjitha vitet e shkollës së mesme, përfshirë rezultatin në Maturën Shtetërore të provimit me zgjedhje;
- **Mes<sub>(Kimi)</sub>**, nota mesatare e thjeshtë e kimisë në të gjitha vitet e shkollës së mesme përfshirë rezultatin në Maturën Shtetërore të provimit me zgjedhje;
- **K<sub>koef. Shkollës</sub>**, koeficienti i shkollës së mesme, për vitin akademik 2019-2020.

**B. Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës**, për programet e integruara të studimit:

- Master i Shkencave në Arkitekturë-Profilin Arkitekt
- Master i Shkencave në Arkitekturë-Profilin Urbanist

Dhe për programin e studimit:

- Bachelor në Arkitekturë Interieri dhe Dizajn



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS  
REKTORATI

Drejtoria e Kurrikulave

ka vendosur këto kritere:

- Kandidatët duhet të kenë mesataren e shkollës së mesme mbi 6 (gjashtë).
- Renditja e aplikantëve do të bëhet referuar pikëve të grumbulluara sipas formulës:

$$0.6 * Mes_{(VKM)} * K_{koef. Shkollës} * 1000 + 0.4 * T_{(Testi)} * 100$$

**Mes<sub>(VKM)</sub>**, nota mesatare e përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave për vitin akademik 2019-2020, sipas Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë, në Republikën e Shqipërisë" neni 74, pika 1;

**K<sub>koef. Shkollës</sub>**, koeficienti i shkollës së mesme, për vitin akademik 2019-2020.

**T<sub>(Testi)</sub>**, rezultati i testimit, i organizuar nga Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës, i cili përbëhet nga katër (4) komponentë:

- Test i arsimit logjik 25% T<sub>(Testi)</sub>, (25 pikë)
- Test i kulturës së përgjithshme 25% T<sub>(Testi)</sub>, (25 pikë)
- Test i historisë dhe historisë së arkitekturës 25% T<sub>(Testi)</sub>, (25 pikë)
- Test i vizatimit dhe prezantimit 25% T<sub>(Testi)</sub>, (25 pikë)

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

Rektori

**Prof. Dr. Andrea MALIQARI**